

VENDIM
Nr. 40, datë 13.5.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË “GJURR REC” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES NGA HEC “MALLA”

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6; 7 dhe 8 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007; nenit 18 pika 1 germa “d” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21 datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 13.5.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gjurr Rec” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për HEC “Malla”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Gjurr Rec” sh.p.k. është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

-Neni 7, pika 1 , gerrat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

-Neni 7, pika 2, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

-Neni 7 pika 3, gerrat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Gjurr Rec” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues nga HEC “Malla”, si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti